

# **NJOFTIME FITUESI PËR PROCEDURA TË KUFIZUARA**

## **BASHKIA LEZHË**

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR

PËR:

OPERATORIN EKONOMIK “ARENA MK” SHPK, ME ADRESE RRUGA NACIONALE  
BALLSH-FIER, NDERTESA PRIVATE NR. 2, ZONA KADASTRALE 1566, NR. PASURIE  
93/14, 9300, DUKAS, BALLSH, FIER

BASHKIMIN E OPERATOREVE EKONOMIK “G & L CONSTRUCTION” SHPK &  
“DRICONS” SHPK, PERFAQESUAR NGA OE “G & L CONSTRUCTION” SHPK, ME  
ADRESE NJESIA BASHKIAKE NR. 6, RRUGA E QELQIT, PALLATET E FIRMES DERVENI,  
KULLA 8, NJESIA NR. 4, KOMBINAT, TIRANE

\* \* \*

Procedura e prokurimit: E Kufizuar, Sherbime (Procedure e pershpejtuar Rindertimi).

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-55566-12-30-2022.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Riforcimi i njesive  
te banimit ne ndertesat (pallat), ne kuader te procesit te rindertimit, ne territorin e Bashkise Lezhe”  
Loti II.

Kohezgjatja e kontrates: Afati i realizimit te mbikqyrjes se punimeve do te jete i njejte me afatin e  
realizimit te punimeve nga shoqeria ndertimore e cila do te zbatoje punimet.

P.S: Afatet mund te jene te ndryshushem ne varesi te kontrates per te cilen do te realizohen punimet.  
Ky informacion do t’u vihet në dispozicion Operatorëve ekonomik palë të Marrëveshjes Kuadër, gjatë  
Fazës së dytë të procesit të minikonkurimit.

Kohezgjatja e Marreveshjes Kuader: 12 Muaj nga data e nenshkrimit te saj.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: X oferta ekonomkisht më e favorshme ☐ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë:

1. Operatori Ekonomik “ARENA MK” SH.P.K, me Nuis L67619801Q,
2. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “G & L CONSTRUCTION” SH.P.K, me Nuis L61901013N  
& “DRICONS” SH.P.K, me Nuis L52013020H,

3. Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” SH.P.K, me Nuis L01717030C,
4. Operatori Ekonomik “REAN 95” SH.P.K, me Nuis J61827043V,

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- 1- Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” SH.P.K, me Nuis L01717030C,
- 2- Operatori Ekonomik “REAN 95” SH.P.K, me Nuis J61827043V,

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

**I-** Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO”SH.P.K, me Nuis L01717030C,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Nuk ploteson piken 2.3.4 ku parashikohet se: “Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij, dhe të figurojnë në liçencën e shqërisë (Drejtues teknik) përsonei si më poshtë:

a. Inxhinier Ndërtimi	1 (nje)	Diplome Universitare
b. Inxhinier Elektrik	1 (nje)	Diplome Universitare
c. Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)	Diplome Universitare
d. Inxhinier Mjedisi	1 (nje)	Diplome Universitare
e. Inxhinier Topograf	1 (nje)	Diplome Universitare

Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si Diploma, Liçencat profesionale përsonele të mbikëqyrjes, Kontrata e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhen Shtator 2022 – Nentor 2022. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat perkatese”.

KVO verën se për te permbushur kete kriter operatorët ekonomik pjesmarres duhet te paraqesin për stafin e mesipërm Diplomat, Liçencat profesionale përsonele të mbikëqyrjes, Kontratat e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhen Shtator 2022 – Nentor 2022. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat perkatese.

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky OE ka paraqitur si inxhinier mjedisi, Zj. S. Hila, por nga verifikimi i dokumentacionit bashkengjitur ne SPE verehet se ky i fundit është diplomuar ne degen “Kimi Industriale”, si “Kimi Teknolog” prane Fakultetit te Shkencave te Natyres ne Universitetin e Tiranës.

Theksojme se për te permbushur piken 2.3.4, OE-te, ne lidhje me disponueshmerine e nje inxhinieri mjedisi duhet qe nje nga drejtuesit teknik te jete i pajisur me diplome për inxhinieri mjedisi te leshuar nga nje Fakultet Inxhinierik i cili ka program studimi për Inxhinieri Mjedisi. Rrjedhimisht nje drejtues teknik i diplomuar si Kimist-Teknolog nuk përmbush kerkesat e pikes 2.3.4, te DST-se pasi nuk disponon diplome universitare si Inxhinier Mjedisi.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbështetur nenin 76, pika 3/a dhe ne nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet

kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “NOVATECH STUDIO” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

*Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” SH.P.K, me Nuis L01717030C, skualifikohet.*

## **II- Operatori Ekonomik “REAN 95” SH.P.K, me Nuis J61827043V.**

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk plotëson kriterin 1, në lidhje me Kriteret e përgjithshme të pranimit/ kualifikimit dhe kriterin 2.1., të kushteve të veçanta të kualifikimit në të cilin përcaktohet se “2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

*Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 9”*

KVO, verën se në kriteret e përgjithme të pranimit, parashikohet si më poshte:

### **“1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

*Ofertuesi duhet të deklarojë se:*

a) *Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.*

b) *nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)*

c) *nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 42 të Aktit Normativ.*

ç) *nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet përgjegjëse.

Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9”.

KVO verën se ne përputhje me Deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas Shtojcës 9, operatori ekonomik duhet të deklarojë si me poshte:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në nenin 42 të Aktit normativ nr.9/2019.
- Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 42 të Aktit Normativ nr.9/2019.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Operatori Ekonomike nuk ka plotësuar të dhenat për personin/at në cilësinë e anëtarit të anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, në Deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”, sipas Shtojcës 9.

KVO referuar vendimit të KPP nr. 537/2019, datë 14.08.2019, në të cilin ka vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues në këtë vendim pikerisht sepse nuk ka plotësuar e deklaruar të gjithë emrat sipas formatit të shtojcës së DST.

Konkretisht, KPP në këtë vendim shprehet:... “KPP gjykon se në rastin konkret nuk jemi në kushtet e devijimit të vogël apo pamundësisë së autoritetit kontraktor për të verifikuar se kush është ortaku i shoqërisë Marketing&Distribution shpk, por jemi përballë mosplotësimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese”.

*Formati i shtojcës e kërkon që të citohen emrat konkretë të të gjithë subjekteve të përmendur më sipër në mënyrë nominale ndryshe shtojca do të ishte konceptuar në mënyrë të përgjithshme. Për këtë shkak shtojca e dorëzuar nga anëtarit i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë 11 Marketing&Distribution shpk nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar”.*

Sa me lart KVO verën se formati i shtojcës 9, e kërkon që të citohen emrat konkretë të të gjithë personave në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendim marrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik në mënyrë nominale ndryshe shtojca do të ishte konceptuar në mënyrë të përgjithshme.

Për këtë shkak shtojca nr. 9, e dorëzuar nga OE nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar, duke mos përmbushur kete kriter.

Se dyti, nuk ploteson piken 2.3.4 ku parashikohet se *“Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij, dhe të figurojnë në liçencën e shqërisë (Drejtues teknik) përsonele si më poshtë:*

a. Inxhinier Ndërtimi	1 (nje)	Diplome Universitare
b. Inxhinier Elektrik	1 (nje)	Diplome Universitare
c. Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)	Diplome Universitare
d. Inxhinier Mjedisi	1 (nje)	Diplome Universitare
e. Inxhinier Topograf	1 (nje)	Diplome Universitare

*Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si Diploma, Liçencat profesionale përsonele të mbikëqyrjes, Kontrata e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën Shtator 2022 – Nentor 2022. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat perkatese”.*

KVO verën se për te përmbushur kete kriter operatorët ekonomik pjesmarres duhet te paraqesin per stafin e mesiperm Diplomat, Liçencat profesionale përsonele të mbikëqyrjes, Kontratat e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën Shtator 2022 – Nentor 2022. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat perkatese.

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky OE ka paraqitur si inxhinier mjedisi, Z. P. Kotorri, por nga verifikimi i dokumentacionit bashkengjitur ne SPE verehet se ky i fundit eshte diplomuar ne degen “Kimi Industriale”, si “Kimi Teknolog” prane Fakultetit te Shkencave te Natyres ne Universitetin e Tiranes.

Theksojme se për te përmbushur piken 2.3.4, OE-te, ne lidhje me disponueshmerine e nje inxhinieri mjedisi duhet qe nje nga drejtuesit teknik te jete i pajisur me diplome per inxhinieri mjedisi te leshuar nga nje Fakultet Inxhinierik i cili ka program studimi per Inxhinieri Mjedisi.

Rrjedhimisht nje drejtues teknik i diplomuar si Kimist-Teknolog nuk përmbush kerkesat e pikes 2.3.4, te DST-se pasi nuk disponon diplome universitare si Inxhinier Mjedisi.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 76, pika 3/a dhe ne nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a)

përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “REAN 95” SH.P.K, me Nuis J61827043V, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

*Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “REAN 95” SH.P.K, me Nuis J61827043V, skualifikohet.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:

1. Operatori Ekonomik “ARENA MK” SH.P.K, me Nuis L67619801Q,
2. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “G & L CONSTRUCTION” SH.P.K, me Nuis L61901013N & “DRICONS” SH.P.K, me Nuis L52013020H,

*Shënim: Referuar VKM nr.225, datë 12.04.2021 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, kualifikimi i ofertuesëve në fazën e parë, nuk është me pikë.*

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë zyres së protokollit të Bashkisë Lezhe, së bashku me dokumentacionin e noterizuar të ofertes tuaj, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 18/01/2023

Ankesa: Nuk Ka.